

---

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“DELTA TRANSPORTNI SISTEM D.T.S” Sh.p.k.**

---

**AKT- THEMELIMI  
I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“DELTA TRANSPORTNI SISTEM D.T.S” Sh.p.k.**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve themelues të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“DELTA TRANSPORTNI SISTEM D.T.S” Sh.p.k.** dhe me emër tregtarë **“DTS TIRANA”**, zotërohet nga ortakët:

- 1. DELTA TRANSPORTNI SISTEM-D.T.S**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar regjistruar me numër regjistrimi 5-0755060/004, me adresë të selisë : Vladike Ruvima II Boljevica, Br. 22, Podgoricë.

Në përputhje me vullnetin tonë të lirë dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendosëm të hartojmë këtë akt themelimi të shoqërisë **“DELTA TRANSPORTNI SISTEM D.T.S” Sh.p.k.** mbi bazën e këtyre principeve:

**NENI 1  
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar. Emri i shoqërisë **“DELTA TRANSPORTNI SISTEM D.T.S” Sh.p.k.**

**NENI 2  
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3  
SELIA**

Selia e shoqërisë është ne adresën: Rruga Norbert Jokl, Ndertesa Nr. 2, Hyrja 1, Njesia Administrative Nr. 2, Tiranë, Albania.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim të asamblesë, mund të hapen degë, filiale, agjensi ose përfaqësi brënda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarinë shoqëria.

**NENI 4**  
**KOHËZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQËRISË**

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedurë likuidimi, sipas rasteve të parashikuara me ligj.

**NENI 5**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria “**DELTA TRANSPORTNI SISTEM D.T.S**” Sh.p.k ka si objekt :

- 1- Transport kombëtar dhe ndërkombëtar i mallrave. Organizimi dhe realizimi i transportit të mallrave brenda dhe jashtë vendit përmes mjeteve të ndryshme, përfshirë transportin rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror.
- 2- Shërbime logjistike dhe menaxhim i zinxhirit të furnizimit: Ofrimi i shërbimeve logjistike që përfshijnë ruajtjen, magazinimin, menaxhimin e inventarit, përgatitjen e dokumentacionit doganor, dhe koordinimin e proceseve të dërgimit dhe pranimit të mallrave.
- 3- Transport i kombinuar dhe intermodal: Planifikimi dhe zbatimi i transportit intermodal që përfshin përdorimin e disa mjeteve të ndryshme të transportit për të maksimizuar efikasitetin e dërgimit të mallrave.
- 4- Shërbime të ndërlidhura me doganat: Kryerja e procedurave doganore për import-eksport, përfshirë shërbimet e deklarimit doganor dhe konsulencën për çështje tarifore dhe doganore.
- 5- Shërbime konsulence dhe planifikim logjistik: Ofrimi i shërbimeve këshilluese për planifikimin, zgjidhje logjistike dhe optimizimin e sistemit të furnizimit.
- 6- Shërbime përkujdesi dhe sigurimi të mallrave gjatë procesit të transportit dhe logjistikës.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër të lejuar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj të veprimtarisë.

## **NENI 6**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 Euro i cili i konvertuar me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë : 1 Euro = 98.19 Leke është 981,900 (Nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind Leke) .Kapitali themeltar i shoqërisë zoterohet nga:

- 1. DELTA TRANSPORTNI SISTEM-D.T.S**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar regjistruar me numër regjistrimi 5-0755060/004, me adresë të selisë : Vladike Ruvima II Boljevica, Br. 22, Podgoricë. cila zoteron 1 (nje) kuote ne vlerën 981,900 lekë (Nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind Lekë ) e cila perfaqeson 100% te kuotave te kapitalit te shoqërisë.

Kapitali themeltar i shoqërisë do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne një llogari të hapur në emër të shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dyte.

## **NENI 7**

### **AKTET E SHOQËRISË**

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akt-themelimi edhe me norma të percaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8**

### **ORGANET DREJTUESE**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator edhe pse nuk është ortak. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërisë “**DELTA TRANSPORTNI SISTEM D.T.S**” **Sh.p.k.**, ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator i shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare, është emëruar:

**Srdan Pejovic**, të cilit i besohen të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm dhe i identifikuar me pashaportë me Nr. ID. A41AD2044.

**NENI 9**  
**DISPOZITAT E FUNDIT**

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 2 ekzemplare, në gjuhën shqipe secili ekzemplarë ka fuqi të njëjtë ligjore.

**Tiranë, 22/11/2024**

**ORTAKËT E SHOQËRISË**

**“DELTA TRANSPORTNI SISTEM D.T.S” Sh.p.k.**

*(përfaqësuesi sipas vendimit të ortakut)*

*Stedjan Perxovic*

